

## Njësia 4

### Edukimi për Qytetari Demokratike dhe për të Drejtat e Njeriut -

#### Një histori e shkurtër e metodës së Këshillit të Europës

### 1. Tablo e përgjithshme

Këshilli i Europës, si organizata më e vjetër evropiane u themelua në vitin 1949, si rrjedhojë e Luftës së II Botërore. Qëllimi i saj kryesor është të mbrojë dhe të zhvillojë të drejtat e njeriut, të demokracisë dhe shtetit të së drejtës në Europë. Këshilli i Europës është aktiv në shumë fusha, duke përfshirë këtu edhe fushën e arsimit dhe të kulturës.

Për më shumë se 50 vjet, ai ka zbatuar një numër të madh projektesh bashkëpunimi për të zhvilluar kulturën e demokracisë dhe të të drejtave të njeriut në të gjithë Europën.

Në fillim të viteve 90', si rrjedhojë e proceseve demokratike në vendet e Eurpoës Lindore, Këshilli i Europës iu nënshtrua ndryshimeve të rëndësishme: numri i anëtarëve të organizatës u dyfishua në një periudhë 10 vjeçare. Këto kohë ndryshimi kishin nevojë për më shumë punë sistematike për të mësuarit e demokracisë. Në vitin 1997, Kryetarët e shteteve dhe të qeverive të Këshillit të Europës nisën një projekt të ri, Edukimi për Qytetarinë Demokratike (EQD). Që nga ajo kohë, ky projekt është rritur në përmasa të mëdha, duke fituar edhe një dimension të ri, atë të drejtave të njeriut. Sot projekti quhet "Projekti i Edukimit për Qytetari Demokratike dhe për të Drejtat e Njeriut (EQD/EDNJ)

Me anë të këtij projekti, qeveritë e shteteve Evropiane pranojnë se njerëzit nuk kanë lindur me aftësitë e qytetarit demokrat dhe për këtë arsye ata duhet të mësojnë si të bëhen të tillë. Në fund të shek. 20-të, shoqëritë evropiane filluan të përballen me probleme të tilla, si apatia politike, lëvizjet massive migratore që çuan në rritjen e diversitetit social, në rritjen e rreziqeve mjedisore dhe të dhunës. EQD/EDNJ u vlerësua i rëndësishëm për zgjidhjen e problemeve të tilla. Ai ka të bëjë me nxitjen e pjesëmarrjes konkrete në jetën publike gjatë gjithë jetës, me përgjegjësinë, solidaritetin, respektin e ndërsjellë dhe dialogun. Ekspertët më të mirë të fushës, nga e gjithë Europa, janë mbledhur rregullisht në 13 vitet e fundit për të punuar në këtë drejtim.

### 2. Rezultatet e projektit të EQD/EDNJ

Vitet e para të projektit iu kushtuan përcaktimit të koncepteve kryesore. Disa prej publikimeve të këtyre viteve trajtojnë çështjet e nevojës së një strategjie dhe të aftësive për ushtrimin e qytetarisë demokratike. Në vitin 2002, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës miratoi Rekomandimet për Edukimi për Qytetari Demokratike (Recommendation Rec(2002)12). Ky ishte dokumenti i parë që i kushtojë kësaj çështjeje në nivel evropian ( Dokumenti i dytë madhor është Karta e Këshillit të Europës për Edukimi për Qytetari Demokratike dhe për të Drejtat e Njeriut,<sup>2627</sup> shih më poshtë). Ai përcakton që EQD duhet të bëhet "objektiv parësor i politikë bërjes dhe i reformave në arsim".<sup>28</sup>

Në vitin 2002 u ngrit rrjeti i koordinatorëve të EQD/EDNJ, i përbërë nga përfaqësues të shteteve anëtare, i cili kishte si qëllim të lehtësonte procesin e shkëmbimit dhe të bashkëpunimit ndërmjet shteteve anëtare në këtë fushë. Ky rrjet është shndërruar në një vlerë të pallogaritshme për nxitjen dhe zhvillimin e EQD/EDNJ. Në rajone të veçanta të Europës u zbatuan projekte rajonale, si për shembull, në Europën Juglindore. Viti 2005 u shpall Viti European i Qytetarisë përmes Arsimit me parullën "Të

26. Nga Olaf Olafsdottir, Drejtore ekzekutive e Drejtorisë së Edukimit dhe Gjuhëve, e KE

27. Karta e KE për EQD/EDNJ e miratuar në kuadrin e Rekomandimit (CM/Rec (2010)7 të Komitetit të Ministrave.

28. Rekomandimi Rec (2002)12, Komiteti i Ministrave i KE drejtuar shteteve anëtare për edukimi për qytetari.

mësojnë dhe të jetojnë Demokracinë”. Viti 2005 shërbeu si një ngjarje e veçantë për rritjen e vetëdijes në shtetet anëtare për EQD/EDNJ. Në një mënyrë ose në një tjetër, pothuajse të gjitha shtetet anëtare morën pjesë në “Vitin” e qytetarisë dhe vlerësimi i bërë nga partnerë të shumtë për të përbërë një përvojë shumë pozitive në këtë fushë.

Megjithatë, që në fillim ishte e qartë se ta bësh realisht edukimin për qytetari demokratike dhe edukimin për të drejtat e njeriut përparësinë më të lartë të politikave arsimore në shtetet anëtare nuk detyrë e thjeshtë, megjithë përvojat e ndryshme që ekzistojnë në secilin prej tyre në këtë drejtim.

Ta bësh EQD/EDNJ një objektiv themelor të sistemit arsimor kërkon një filozofi të re, si nga pikëpamja e metodologjisë, ashtu edhe nga pikëpamja e punës organizative. Studimet e kryera në kuadrin e këtij projekti, duke përfshirë këtu edhe “*Studimin mbarë Europian për politikën e EQD*”,<sup>29</sup> shtrojnë nevojën për përgatitjen e dokumenteve dhe instrumenteve praktikë, që do të shërbejnë për ngushtuar hendekun ndërmjet politikës dhe praktikës. Për këtë arsye, përgatitja e dokumenteve dhe e instrumenteve të tillë, shkëmbimi i praktikave të mira dhe rritja e bashkëpunimit, ndërmjet dhe brenda vetë shteteve anëtare, u bënë përparësi të projektit për vitet 2006-2009. Këto përparësi përcaktuan edhe tri fusha kryesore pune: zhvillimi i politikës, trajnimi i profesionistëve në arsim dhe qeverisja demokratike e institucioneve arsimore. Për të gjitha fushat, Këshilli i Europës zhvilloi instrumente praktike siç janë edhe këto manuale për mësuesit.

Puna e shumë viteve, kulmoi në maj të vitit 2010, me miratimin e Kartës së Këshillit të Europës për Edukimin për Qytetari Demokratike dhe Edukimin për të Drejtat e Njeriut, në kuadrin e Rekomandimit (CM/Rec(2010)7 të Komitetit të Ministrave të të gjithë 47 shteteve anëtare të Këshillit të Europës). Ky dokument kuadër politik do të jetë një pikë e rëndësishme referimi për të gjithë Europën dhe do të përdoret si bazë për punën e ardhshme të Këshillit të Europës në këtë fushë.

---

29. Birzea et al. (2004), Studimi mbarë europian për politikën e EQD, Botimi i KE, Strasbourg.

### 3. Instrumente praktikë

#### 3.1 Paketa e EQD/EDNJ

Instrumentet e ndryshme të përgatitura nga Këshilli i Europës përmbajnë informacion të rëndësishëm për aspekte të ndryshme që lidhen me integrimin e EQD/EDNJ në sistemet arsimore. Ndër këto instrumente, më i rëndësishmi është ai që quhet “Paketa EQD/EDNJ”, e cila përmban:

- Instrumenti 1: Instrumenti Politik për EQD/EDNJ: mbështetje strategjike për vendimmarrësit;
- Instrumenti 2: Qeverisja demokratike e shkollës;
- Instrumenti 3: Si mund të mbështesin të gjithë mësuesit edukimin qytetar dhe edukimin e të drejtave të njeriut: kuadër për zhvillimin e kompetencave;
- Instrumenti 4: Sigurimi i cilësisë së edukimit për qytetari demokratike në shkollë;
- Instrumenti 5: Partneriteti komunitet shkollor-universitet, për një demokraci të qendrueshme: Edukimi për Qytetari Demokratike në Europë dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Këto instrumente janë zhvilluar nga ekspertë nga shtetet anëtare të Këshillit të Europës, në bazë të vërejtjeve dhe komenteve të marra nga grupe të ndryshme, duke përfshirë këtu edhe koordinatoret kombëtarë të EQD/EDNJ. Materiale të tjera plotësuese, përveç kësaj pakete, mund të gjenden në uebsait-in e Këshillit të Europës ([www.coe.int/educ](http://www.coe.int/educ)).

Këto instrumente praktikë të përgatitura nga Këshilli i Europës në fushën e EQD/EDNJ janë instrumente të përgjithshme. Kjo do të thotë që ato mund të kenë nevojë për t’u përshtatur dhe për t’u përdorur në varësi të nevojave të çdo vendi.

#### 3.2. Gjashtë vëllimet e EQD/EDNJ në projekte shkollore, njësi mësimore, koncepte, metoda dhe modele

Në shumë vende, mësuesit kanë nevojë për ndihmë në zbatimin e EQD/EDNJ. Kjo është arsyeja përse Këshilli i Europës vazhdimisht harton manuale për mësuesit për edukimit qytetar dhe të të drejtave të njeriut.

Vëllimi II:

*Njësi mësimore për edukimin qytetar për arsimin bazë.*

Vëllimi III:

*Jetojmë në demokraci  
Mësime të EQD/EDNJ për ciklin e lartë të arsimit bazë*

Vëllimi V:

*Të explorojmë të drejtat e fëmijëve. Nëntë projekte të shkurtër për arsimin bazë*



**Vëllimi I: Edukimi për demokraci:** *Materiale mbështetëse për edukimi për qytetari demokratike dhe për të drejtat e njeriut për edukimin e mësues*

**Vëllimi VI : Mësimdhënia e demokracisë:** *Përmbledhje modelesh për edukimi për demokraci dhe të drejtat e njeriut*

**Vëllimi IV : Të marrim pjesë në demokraci:** *Njësi mësimore për ciklin e lartë të arsimit të detyruar*

*Vëllimet janë botuar në partneritet me Universitetin e Edukimit të Mësuesve të Zurich-ut, Projekte Ndërkombëtare në Arsim. Agjencia zviceriane për Zhvillim dhe Bashkëpunim mbështeti financiarisht së bashku me Këshillin e Europës botimin e manualeve. Ky libër, Vëllimi I, Edukimi për Demokraci – *Materiale mbështetëse për mësuesit*, është i pari në serinë e gjashtë vëllimeve. Në faqen parardhëse gjëndet një pamje e përgjithshme e të gjashtë vëllimeve dhe e grupeve për të cilat ato janë përgatitur. Manualët përmbajnë njësi mësimore për të gjitha nivelet e shkollimit dhe kanë si qëllim nxitjen dhe zhvillimin e qytetarisë aktive, të bazuar në të mësuarit që ka në bazë pjesëmarrjen dhe detyrën. Karakteristikë e këtyre manualeve është se ata janë produkt i një projekti European. Ideja dhe version i parë i tyre u zhvillua nga nga mësuesit e Bosnje- Herzegovinë, të cilët morën vetë pjesë në përgatitjen e manualeve. Autorët dhe redaktorët përgjegjës për variantin e fundit janë nga vende të ndryshme të Europës. Manualët janë testuar dhe rishikuar nga një numër i madh specialistësh me prejardhje të ndryshme kulturore. Në shpresojmë që ato të jenë të dobishëm për mësuesit dhe nxënësit në të gjithë Europën.*